

V E N D I M
Nr. 316, datë 4.7.2002

PËR MËNYRËN E TRAJTIMIT ME STREHIM TË JETIMËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 17 të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e jetimëve", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave, të planifikojë fondet për jetimët që gëzojnë statusin e të pastrehut, sipas kërkesës së organeve të qeverisjes vendore, për trajtimin me përparësi me strehim të tyre.

2. Çdo person që gëzon statusin e jetimit ka të drejtë të bëjë kërkesë për strehim pranë organeve të qeverisjes vendore që nga data e mbushjes së moshës 18 vjeç.

3. Personi i pastrehë, me statusin e jetimit, të trajtohet me banesë nga Enti Kombëtar i Banesave, sipas kriterëve të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha".

4. Shpenzimet operationale të Entit Kombëtar të Banesave të përballohen nga Buxheti i Shtetit, për rastet kur:

individ ose kryefamiljari me statusin e jetimit është i moshës nga 18 deri në 25 vjeç;

-kryefamiljari me statusin e jetimit është grua e ve ose e divorcuar dhe ka fëmijë në ngarkim.

5. Kërkesat për strehim administrohen nga organet e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me Shoqatën e Jetimëve të Shqipërisë. Organet e qeverisjes vendore caktojnë radhën, përparësitë e trajtimit dhe strukturat që i takojnë çdo familjeje. Këto organe, nëpërmjet këshillave bashkiakë ose komunalë, hartojnë listat e të pastrehëve për personat që gëzojnë statusin e jetimit, në çdo kohë, si dhe dokumentacionin e plotë dhe i dërgojnë pranë Entit Kombëtar të Banesave, për planifikim fondesh, brenda datës 1 gusht të çdo viti. Dokumentacioni përmban të gjitha dokumentet që përcaktohen në aktet, ligjore e nënligjore, për strehimin.

6. Qendër banimi për personat që kanë përfituar nga statusi i jetimit të jetë qendra ku ata kanë përfituar statusin e të pastrehut.

7. Sipas kriterëve të këtij vendimi, trajtohen personat që gëzojnë statusin e jetimit, të cilët kërkojnë banesë për herë të parë. Në këtë kategori hyjnë:

-personat e sapo dalë nga jetimore dhe të pasistemuar në konvikte ose me strehim të përkohshëm;

-personat ose kryefamiljarët, që banojnë në konvikte ose mjedise që nuk janë fond banese;

-kryefamiljari grua, me statusin e jetimit, dhe që nuk ka banesë në pronësi.

8. Për hartimin e listave të të pastrehëve me statusin e jetimit nuk zbatohen afatet kohore të përcaktuara në pikën 1 të vendimit nr.250, datë 16.4.1996 të Këshillit të Ministrave "Për procedurat dhe prioritetet në zbatim të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha", ndryshuar me vendimin nr.513, datë 24.11.1997 të Këshillit të Ministrave.

9. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko